



12/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 2692/prot.

Tiranë, më 09/06/2022

URDHËR

Nr. 264, datë 09/06/2022

“PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT,  
NOTERIT [REDAKTUAR]”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “dh”-ij, të pikës 1, të nenit 21, të Ligjit nr. 110/2018 “Për notërinë”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 23, datë 15.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,

KONSTATOJ:

Nëpërmjet njoftimeve në media elektronike, Ministria e Drejtësisë është vënë në dijeni, se me vendim të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë dënuar 11 persona, ndër to edhe noteri z. [REDAKTUAR].

Në vijim të informacionit, të administruar përmes medias elektronike, dhe verifikimit të kryer në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ku rezultoi se, në rubrikën “Njoftime për Median”, në Komunikimin për Media të datës 15.04.2022, është njoftuar në mënyrë të përmblendhur se, më datë 15.04.2022, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është shpallur vendimi për çështjen me nr. [REDAKTUAR] regjistri themeltar, datë 23.09.2021 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurve [REDAKTUAR], nga struktura përkatëse të monitorimit të veprimtarisë noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë, me shkresën nr. 2692, datë 11.05.2022 i është kërkuar informacion Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nëse Vendimi nr. 12 datë 03.02.2021 i kësaj gjykate ka marrë formë të prerë, si dhe përcjelljen e një kopje të tij.

Me shkresën nr. 2692/1 prot., datë 17.05.2022 është kthyer përgjigje nga gjykata, e cila bashkëlidhur kësaj shkrese ka përcjellë fotokopje të njëjësuar me origjinalin të Vendimit nr. 12 datë 03.02.2021, së bashku me shënime të çfarë ka vendosur Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga administrimi vendimit gjyqësor sipërcituar vërejmë se, ndër personat me cilësinë e të pandehurit është dhe shtetasi [REDAKTUAR], i datëlindjes [REDAKTUAR], lindur në [REDAKTUAR].

Mirditë dhe banues në Lezhë. Shtetasi [REDAKTUAR] është licencuar për ushtrimin e veprimtarisë noteriale me urdhrin nr. 2505, datë 04.04.2016 të Ministrit të Drejtësisë, në Bashkinë Lezhë me adresë "Lagjja "Skenderbeg", Rruga "FrangBardhi", GodinaNr. 2, Njesia nr. 2".

Në dispozitivin e këtij vendimi rezulton të jetë vendosur, ndër të tjera:

*"Deklarimin fajtor të të pandehurit Emanuel Gjura për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i Dokumenteve" të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 186/1 dhe 28/4 të Kodit Penal dhe në lidhje me nenin 334/1 të Kodit Penal dënimin e tij me 6 vjet burgim.*

*Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit [REDAKTUAR] në bazë të nenit 388/1, pika "d" e Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk provohet kryerja prej tij e veprës penale të "Shpërdorimit të Tokës", kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 199 dhe 25 të Kodit Penal.*

*Deklarimin fajtor të të pandehurit [REDAKTUAR] për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produktve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287, pika "a", e Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim.*

*Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55/1 të Kodit Penal dënimin e të pandehurit [REDAKTUAR] me një dënim të vetëm prej 7 (shtatë) vjet burgim.*

*Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimisht të të pandehurit [REDAKTUAR] me një dënim prej 4 vjet e 8 muaj burgim, llogaritja e të cilit fillon nga dita e arrestimit dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së lartë."*

Ky vendim lidhur me të pandehurin [REDAKTUAR], rezulton të jetë lënë në fuqi me vendimin nr. 23, Datë 15.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me ndryshimet si vijon:

- a) *Deklarimin fajtor të të pandehurit [REDAKTUAR] për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimit të tokës" të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 199 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.*
- b) *Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55/1 të Kodit Penal dënimin e të pandehurit Emanuel Gjura me një dënim të vetëm prej 9 (nëntë) vjet burgim.*
- c) *Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimisht të të pandehurit [REDAKTUAR] me një dënim të vetëm prej 6 (gjashtë) vjet burgim, i cili do të kryhet në një burg të sigurisë së lartë."*

Me Ligjin nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar, Ministri i Drejtësisë është përcaktuar si autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili jep licencën për ushtrimin e veprimtarisë noteriale të individëve që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si noterë, pezullon ose heq licencën e noterit, si dhe kontrollon, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të ministrisë, zbatimin e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e noterëve.

Ndërkohë, në nenin 21, pika 1, gërma “dh”, i), të po këtij ligji parashikohet se, “1. Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri: ... “dh) është dënuar pas marrjes së licencës me vendim gjyqësor të formës së prerë: i) për një vepër penale të kryer me dashje; ii) për një vepër penale të kryer me pakujdesi, e cila cenon figurën dhe integritetin e profesionit të noterit;”.

Nga parashtrimi rrethanave dhe fakteve sipërcituar, rezulton që noteri [REDAKTUAR] të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287, pika “a”, e Kodit Penal, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287, pika “a”, e Kodit Penal, “Shpëdorimit të tokës” parashikuar në nenin 199, të Kodit Penal.

Për sa më sipër, vlerësojmë se, noteri [REDAKTUAR] gjendet përpara parashikimeve të nenit 21, pika 1 gërma “dh”, i), sipërcituar, pra përpara rastit kur hiqet licenca e një noteri, pasi nga ana e tij me dashje është kryer një vepër penale, për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, konkretisht me vendimin nr. 23, datë 15.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

#### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “dh”, i), të pikës 1, të nenit 21, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 23, Datë 15.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,

#### URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit [REDAKTUAR], anëtar i Degës Vendore të Noterisë Shkodër, pasi është dënuar për kryerjen e një veprë penale me dashje, me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
  - a.) Znj. [REDAKTUAR], specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
  - b.) Znj. [REDAKTUAR], specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
  - c.) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër;
  - d.) Një përfaqësues i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimit të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit [REDAKTUAR], nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij Urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të

Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.

5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

6. Dega Vendore e Noterisë Shkodër dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar.

7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 6, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë, brenda 10 ditëve pune.

8. Ndaj këtij urdhri, noteri mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.

9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë për njoftimin e këtij Urdhri noterit [redacted], Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Degës Vendore të Noterisë Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Manja

